

10.02.2023
Ora 11.07

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për dhënien e mandatit të deputetit z. Gëzim Nuri Ademaj, kandidat i listës shumemërore të Koalicionit Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim, Partia për Drejtësi Integrim dhe Unitet (PDIU), qarku Vlorë, z. Gëzim Nuri Ademaj”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Z. M. Koja
Z. E. Meta, Znj. P. Doçaj**
- **Parti Politike:** **PDIU (Z. K. Xhemali)**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Mirëmëngjes! Atëherë në seancën e sotme kemi për shqyrtim tre çështje në rendin e ditës: projektvendim “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit nga listës shumemërore të koalicionit “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshime”, qarku Vlorë”.

Projektvendimi “Për emërimin e anëtarëve të komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor bazuar në propozimet e Partisë Social-Demokrate”.

Pika e fundit ka të bëjë me vlerësimin e raportit mbi veprimtarinë e institucioneve publike për periudhën 24 janar – 2 shkurt 2023.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.02.2023*

Atëherë fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit nga listës shumemërore të koalicionit “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, qarku Vlorë, z. Gezim Nuri Ademaj”.

Z. Y. Merkaç: Faleminderit! Kuvendi I Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës, si pasojë e dorëheqjes nga mandati i deputetit, të z. Fation Sulo Veizaj, i zgjedhur në zonën zgjedhore, qarku Vlorë, propozuar nga koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”. Koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021. Komisioni Rregullator ka shpallur vendimin përfundimtar të zgjedhjeve ndërsa Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet vendimit nr. 415, datë 23.06.2021, ka miratuar shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues si dhe rirenditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese në zonën zgjedhore, qarku Vlorë. Sipas këtij vendimi koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim” për zonën zgjedhore, qarku Vlorë, për zgjedhjet për Kuvend, ka fituar 4 (katër) mandate. Rezulton se lista shumemërore e koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore, qarku Vlorë, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Zëvendësimi i vakancës do të bëhet në mbështetje të nenit 164 pika 2, të Kodit Zgjedhor si dhe vendimit nr. 415, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në të cilin është miratuar rirenditja e kandidatëve, të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese. Sipas këtij vendimi, rezulton se, kandidatit të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 05 (pesë), z. Gëzim Nuri Ademaj, i cili ka plotësuar e depozituar në

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.02.2023*

Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit, me numër 7 unik. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, konstatohet se ka deklaruar që ndaj tij është caktuar masa e detyrimit për tu paraqitur në policinë gjyqësore, dhe në Vitin 2005 Gjykata e Apelit Vlorë e ka shpallur të pafajshëm, për veprën penale të cilin nuk e ka deklaruar. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile si dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore, dhe pas verifikimeve të kryera konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë konstatohet se të dhënat e kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Vlorë, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Gëzim Nuri Ademaj, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit z. Fation Sulo Veizaj, i përket kandidatit vijues në listën shumëmemërore të koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore, qarku Vlorë, i renditur me numër rendor 05 (pesë), z. Gëzim Nuri Ademaj. Bashkëlidhur kemi projektvendimin për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesi i partisë?

PDIU: Dakord jemi me relacionin.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Mirë, atëherë vendosim:

Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore, qarku Vlorë, z. Gëzim Nuri Ademaj.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.02.2023*

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Faqen Zyrtare të Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Faleminderit!

Vendimi Nr. 46

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.02.2023*

10.02.2023
Ora 11.12

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për emërimin e anëtarëve të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, të propozuar nga Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të dates 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafii KQZ: **Z. Y. Merkaj, Z. M. Koja
Z. E. Meta, Znj. P. Doçaj**
- **Parti Politike:** **PDIU, Z. K. Xhemali**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër.

Z. Y. Merkaj: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendim nr.37, datë 8.02.2023 ka emëruar antarë të propozuar nga Partia Socialdemokrate për në pesëdhjetë e shtatë KZAZ. Partia Socialdemokrate ka depozituar kërkesën për gjashtëmbëdhjetë anëtarë të KZAZ-së, në KZAZ-të e mbetura dhe konkretisht në KZAZ numer 2, 3, 4, 5, 9,15,26, 31, 30, 32, 34, 35,36, 38, 40 dhe 41. Kandidaturat e paraqitura nga partia u shqyrtuan dhe u verifikuan, dhe në përfundim të afateve të dorëzimit plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 30 dhe 31 të Kodit Zgjedhor. Nuk rezultojnë të dënuar në regjistër. Për sa më sipër kemi projektvendimi për shqyrtim dhe miratim, dhe listën. Faleminderit!

***Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI***



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.02.2023*

Z. I. Celibashi: Mirë atëhere miratojmë emërimin e anëtarëve të KZAZ-së, bazuar në propozimet e Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë sipas draftit të propozuar.

Vendimi Nr. 47

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.02.2023*

10.02.2023
Ora 11.13

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për përfundimin e hetimit administrativ të raportimeve të
organeve publike për periudhën 24 janar – 2 shkurt 2023”.**

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaaj, Z. M. Koja**
Z. E. Meta, Znj. P. Doçaj
- **Parti Politike:** **PDIU, Z. K. Xhemali**
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën e tretë që ka të bëjë me raportimin e veprimtarive të institucioneve publike.

Znj. M. Koja: Atëhere Komisioner, sot kemi përfundimin e hetimit administrative të raportimit të organeve publike për periudhën 24 janar- 2 shkurt 2023. U shqyrtuan pretendimet e institucioneve në lidhje me gjetjet e administratës dhe në përfundim të këtij procesi propozojmë që të vendoset sanksion administrative për Bashkitë Berat, Durrës, Fier dhe Roskovec, në masën 10.000 lekë. Ndërsa për institucionet e tjera të pushojë hetimi administrative. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Kjo është periudha deri në 2 shkurt?

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.10.02.2023*

Znj. M. Koja: Po është periudha 24 janar- 2 shkurt 2023.

Z. I. Celibashi: Dakord, atëhere bazuar në vlerësimin që i kemi bërë raportimeve mbi veprimtarinë e kësaj periudhe propozojmë vendosjen e sanksionit administrative për personat përgjegjes për raportimin për Bashkitë Berat, Durrës, Fier dhe Roskovec, në masën e 10.000 lekëve. Mirë, kemi çështje të tjera në rendin e ditës? Nuk kemi! Atëhere seanca mbyllet! Ditë të mbarë!

Vendimi Nr. 50, 51, 53, 54.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*

